

ASIME FERAJ

FUSHA TEMATIKE NË KRIJIMTARINË E FATOS ARAPIT

Prof. Jani Thomai e trajton qartë dhe gjerë teorinë e fushave leksikore dhe tematike: “Parimi themelor i kësaj teorie është: *kuptimi i fjalës mund të përcaktohet vetëm brenda gjithë fushës së fjalëve që shënojnë sende të një gjinie, p.sh. i kuq brenda fushës së fjalëve që shënojnë ngjyrë. Tërësia e leksemave (e fjalëve, e emërtimeve) që mbulojnë një fushë konceptore, formon një fushë leksikore (d.m.th. të gjitha fjalët e kuqe, e verdhë e zezë etj.)*”¹.

Kuptimi i një fjale përcaktohet në sistemin leksikor edhe për arsye se leksemat nuk lidhen një nga një me referimet e tyre, por njëkohësisht në varësi nga lidhjet midis tyre, që kanë gjetur pasqyrim në gjuhë. Folja *blej* nuk është thjesht antonime bashkëplotësuese me *shes*, por nënkupton edhe praninë e një malli që e zotëron dikush dhe të parave, që i ka dikush tjetër e vetëm atëherë mund të realizohet veprimi i blerjes. Në komunikim, këto fjalë përbëjnë skenarin përkatës, nocion që përbën bazën e një drejtimi të gjuhësisë inxhinierike sot, e cila punon për inteligjencën artificiale, të nevojshme për ta bërë të mundur komunikimin me makinat elektronike. Po ashtu *tavani* dhe *dysHEMEJA* së bashku me *çatinë*, *themelin* etj. përbëjnë shtëpinë dhe nuk kanë kuptim pa këto lidhje. Fusha ka kështu në qendër një fjalë themelore, rreth saj është një mikrosistem, por jo i ndërtuar shkencërisht, pasi kemi një përgjithësim specifik gjuhësor, me gjurmë të historisë, të traditave të një bashkësie folësish.

a. Tërësia e mjeteve gjuhësore për të shënuar një copë të realitetit ashtu siç del në përvojën njerëzore dhe në përputhje me natyrën e gjuhës konkrete quhet fushë tematike. Sot ka fjalorë të ndërtuar sipas këtij parimi, ku *shtëpia*, *automobili*, *kali* etj. paraqiten me të gjitha fjalët që lidhen me to, madje tashmë edhe me ilustrimet.

b. Në rast se *kjo copë është një tërësi me elementë të përcaktuar, në marrëdhënie të qëndrueshme e të ngulitura, atëherë kemi fushë semantike*, si p.sh. ngjyrat, lidhjet e farefisnisë. Po të përkthehet e gjithë fusha në një gjuhë tjetër, del qartë natyra e veçantë e shqipes. Një fjalë merr pjesë në më shumë se një fushë, duke zënë pozicione të ndryshme në to.²

Fusha tematike që mbizotëron në krijimtarinë e Fatos Arapit është **vendlindja**.

Atje ku bashkohet Joni dhe Adriatiku, shtrihet Vlora, dikur Aulona, është vendlindja e Fatos Arapi. “*Vendlindja, shprehet një nga studiuesit e shumtë të veprës së tij, zakonisht përcakton identitetin e poetit. Megjithatë nuk vendos për*

¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Dudaj, Tiranë, 2005, f. 87.

² Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2005, f. 244.

talentin, prirjen, sepse për këtë vendosin zotat, koincidenat e shumë rrethanave. Megjithëkëtë, me siguri një ndikim të thellë kanë në jetë, në ngjarjet, në zgjedhjet e rrugëve. Fatos Arapi - një poet i një ndjeshmërie të jashtëzakonshme, i pajisur me një dhunti nga vetë fati: shushurima e valëve të detit antik, ngurtësia e shkëmbinjve, në të cilat ndoshta pushoi Odiseu dhe fiqtë e gjelbër, drurët e ullinjë dhe korijet me lisa. Poetin gjithnjë e shoqëronin shqiponjat ndoshta dhe shpendë grabitqarë, e me siguri pulëbardhat dhe grumbulli i zogjve shtegtarë, të cilat shtigje këtejpari shpienë”.

... Nga poezitë e Fatos Arapit aq shumë kam mësuar për Shqipërinë dhe Shqiptarët, për fatin e poetëve shqiptar dhe të jo poetëve, për emigrantët që përshkuan shumë kontinente, duke mos harruar askurrë se nga e kanë prejardhjen dhe mbi bukurinë magjepsëse të natyrës përreth.”³

Vendlindja e autorit mban aromë portokalli, aromën e ullinjve të pjekur, aromë pishe Llogoraje, aromë dafine, aromën e tokës së sapo punuar e erën e kripës së Jallisë ... etj.

Vendlindja vjen nëpërmjet kujtimeve të fëmijërisë: *A keni parë ju shokë të vranë? Sjell kujtimin e Shyqyri Alimerkos. Në dorë kam pushkën e Fejzo Gjomemës.*

Edhe pse larg vendlindjes e merr atë me vete: *Dhe tani kudo që jam Më ndjek pas deti apo ... në të plasurat e buzëve / më djeg jodi e kripa e detit. / Nuk u durokam dot më Këputjen e trupit prej trupit.*

Është krenar për vendlindjen, nuk mban asgjë në hije gjithçka është thënë me mall e nostalgji. Poeti herë është Naim, herë Poradec, herë Dritëro e herë të gjithë bashkë: *Kudo që shkoj jam një copëz peizazhi nga vendi im. Tani tymi i përhimtë i tyre / Zvërnecin mbështjell e vë në gjumë... apo Ky mall i përjetshëm Llogoraje më mbeti në sy.*

Testament janë fjalët: *Dhe kur të vdes s’dua asgjë / veç një varrë të thjeshtë / atje në bregdet.*

Zërat e vendlindjes e shoqërojnë ngado, që nga këngët labe: *... dy tri këngë labe dhe stërkala gjoli....*, blegërima e deleve, e dhive, e valëve të detit, si dhe Zërat e gjelbër të ullirit.

Krenar për historinë e lashtë të vendlindjes, që nga Aulona e vjetër e Akrokeraunët (mali i Vetëtimës) deri tek Llogoraja e Sazani: *Është e dhimbshme Aulona. / Akrokeraunët vazhdojnë punën e tyre të përhershme, / prodhojnë vetëtimën.*

Vendlindja e tij shfaqet me të gjitha ngjyrat: *Ngjyrat e Jonit / Tani tymi i përhimtë i tyre / Në gjelbërimin e përhershëm. / Papritur përnjëherësh ranë njollat e bardha. / Lulëkuqet në arë vetëtimën*

Deti zë një vend të veçantë në krijimtarinë e Fatos Arapit. Ai është lidhje shpirtërore jo vetëm individuale, por edhe kolektive. Vetë qyteti është i lidhur me detin, gjithçka që lidhet me këtë qytet lidhet me detin, me të sotmen e me të shkuarën e tij: *Deti. Asgjë nuk mund ta ndante qytetin tonë prej detit. Mua më*

³ www.zemrashqiptare.net/.../Mazllum-Saneja:-Fatos-Arapi-në-gjuhën-pol...

dukej sikur gjatë gjithë ekzistencës së vet ai qytet i vogël kishte shkuar drejt detit, drejt frymës, shushurimës, lëvizjes së përjetshme të horizonteve të tij. Një pjesë e jetës së atij qyteti i takonte detit, me anijet, hamejt, molet, maunet. Armiqtë kishin ardhur dhe prej detit, por jo si monstra të paqena e fantazmagorike. Armiqtë kishin ardhur, ashtu si vijnë armiq nga deti, apo nga toka qoftë. Dhe qyteti ynë përherë ashtu i kishte pritur ata, si armiq. (Dikush më buzëqeshte, f. 130).

Deti jo vetëm ndan, shpesh deti është përdorur si lidhje me një tjetër botë, të munguar dhe shumë të dëshiruar. Në krijimtarinë e tij autori, me mënyra të ndryshme, kërkon ta kapërcejë detin, sepse andej shikon shpëtimin, shpresën.

Deti jepet i mitizuar në sytë e banorëve: Në pastë edhe për ne *një perëndi deti* është, vetëm deti **“Deti në mes”**.

Studiuesja e mirënjohur Shefkije Islamaj, në veprën “Gjuha e Jakov Xoxës” thekson: “Në fushat tematike ajo që bie në sy është mënyra e lidhjes së fjalëve. Siç dihet, fjala ka një rreth mjaft të gjerë lidhjesh me fjalë të tjera, ndërsa te Xoxa mund të hetohet qartë se sa të gjera janë këto lidhje për fjalë të ndryshme. Interesante janë veçmas fushat leksikore, fusha ku përfillet organizimi tematik. Leksiku i një fushe sajón mikrosisteme leksikore shumë origjinale. P.sh.: fjala *kripë* në romanin **“Lulja e kripës”** dëshmon se në ç’gjerësi mund të shtrihen lidhjet e një fjale, dhe ç’mundësi krijon autori e ç’mundësi jep shqipja në këtë drejtim.”⁴.

Vlora një qytet bregdetar dhe është më se e natyrshme, që poeti ynë fushën tematike e lidh me detin, me ullinj të portokallet, duke krijuar kështu mikrofusha befasuese.

Autori e njeh mirë detin. Kjo njohje e ka ndihmuar të realizojë organizime stilistike shumë shprehëse, dhe një sërë figurash stilistike. Deti vështrohet nga këndvështrime të ndryshme, duke sjellë detaje nga më të hollësishmet.

Poeti e ndez dhe fik detin, duke i thyer kufijtë e fantazisë, ashtu siç thyen edhe kufijtë e lidhjeve gjuhësore me këtë fjalë.

Krahas pasurisë tematike, ideore, artistike vepra vlerësohet dhe për pasurinë gjuhësore të jashtëzakonshme. Gjuha e veprës së këtij shkrimtari është mbështetur në gjuhën e popullit nga gjiri i të cilit doli.

Emër + emër: *Një guaskë deti i mbiu përpara syve, në fushën e hapët të detit, kallam të egër prej detit, zinte hyrjen e gjirit të detit, bregun tjetër të detit, i ngjante një guri në fund të detit që ruan gjurmët e valëve, në hapësirën e vrenjtur të detit, fluturonte ulët mbi valët e detit, panë tek vinte në drejtim të detit, i varrosur atje te kodra anës detit, duke shkuar prapë anës së detit. Ndjeu ajrin e pastër të detit që i mbushi mushkëritë, atë përflakje të detit e të qiellit **“Deti në mes”**; ky dallgëzim qiellor i deteve, Duke shkelur nëpër guaca të detit ndjeva ditën e sotme të çelë, prej zërave të shumës së detit do të ribëjë sërish, më djeg jodi dhe kripa e detit, zë i përmallshëm hutues i detit, fshihen fundeve të detit, lotëve do ti mohohet gryka e detit, fluturojnë zogjtë e detit, në gjire të fushës së*

⁴ Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës: Veçori leksiko-semantike dhe stilistike*, Tiranë, 2001, f. 66.

detit e legjendave, ujërat e qiellit dhe *ujërat e detit të Vlorës*, Mashtrojnë horizontet në *detin e hiçëve*, një dëshpërim në *detin e dëshpërimeve*, në brigjet e *detit të gjaktë të jetës*, qante ndanë *detit të zilisë së egër “Eklipsi i ëndrrës”*; loz me kohën e kreshtë të *detit “In-tenebris”*; romantika e *detit*, erërat e *kripura të detit*, hapësirë e *kaltër dhe e pamatur e detit*, zërat e *përhershëm të detit*, *deti i atdheut*, **“Dikush më buzëqeshte”** ndër harlisje të *detit Mesdhe*, prej mjegullash *deti*, më djeg jodi e *kripa e detit “Poezi”*.

Emër + mbiemër: dhe e ftohtë e *artilerisë detare* përflak sërish horizontin, *Betejë detare*, në kënetë e jo më në *det të hapët*, Pastaj *deti i gjerë që shtrihej pa fund*, **“Deti në mes”**; në ato kohë *lufte deti* ishte gëzimi më i madh, *deti* ishte fare i qetë, **“Dikush më buzëqeshte”**.

Emër + folje: deri këtu *kishte sjellë deti*. Mjaftonte që të *kujtonin detin*, Mjaftonte që të *kujtonin detin dhe të shpresonin*, ai kishte ecur vetëm *drejt detit*, kulloste e *pillte larg ndanë detit*, do ti *largoheshin detit* që ishte e vetmja shpresë, Nga *deti fryu jugu i ngrohtë*, **“Deti në mes”**; i madhërishëm më *ndjek pas deti*, me zërat e vet të *na gënjejë deti*, Atje tutje *hapej deti* që thëthinte Vjosën vetë, Po nisem *pa u përshëndetur me detin*, Përse paskam frikë *ti afrohem detit*, Roveli *fliste e shikonte detin* e thellë. Hapësirat e kaltra, **“Eklipsi i ëndrrës”**; *qyteti i takonte detit*, *ardhur dhe prej detit “Dikush më buzëqeshte” flet e shpërndan deti matanë*, më *ndjek pas deti... pa u përshëndetur me detin “Poezi”*.

Emër + ndajfolje: *andej nga deti* u hap një copëz qielli, ngulur shikimin *andej nga deti*. *Andej ishte gjithë jeta*, **“Deti në mes”**; *detimatanë “Eklipsi i ëndrrës”*.

Lidhje të tjera: e ndanin *kishën prej detit “Deti në mes”*; prej lotëve tanë një *det* që ajo nuk e njeh, isha unë *deti* që të përkundte në gji **“Eklipsi i ëndrrës”**.

Krahasim: *ne ishim të dysi qielli me detin* kur vrenjte njëri nxinte tjetri **“Eklipsi i ëndrrës”**; Sot *Azemi është si ai deti që nxjerr jashtë çdo gjë “Shokët”*; sy hapësire *deti “Dikush më buzëqeshte”*.

Shprehje: Edhe ata. Cilët? Ata *matanë detit*. Edhe ata janë kundër nesh, dhe mund ta *hedhin detin më lehtë*, **“Deti në mes”**.

Njësi frazeologjike: *çante tani këtë det*, ju mendoni për kokën tuaj se *detit me këmbë nuk i bihet*, si dhe emërtimin: ku flinin në mbrëmje *pulat e detit*, **“Deti në mes”**.

Përshkrime: shikonintë *habitur atë përflakje të detit* e të qiellit Një hop gjithçka *Syprina e zezë e detit* u ndez. Ishulli i errët nxiu, me re e shi *nëpër mjegullën e detit* rrëshqiti një varkë **“Deti në mes”**; *Anës së deteve skela*, limane **“Ritme të hekurta”**;

Fjalëformim: nuk e priste askush në *Kodërdet*, **“Deti në mes”**.

Hapësira e trojeve të Labërisë e njeh blegtorinë si mjeshtërinë kryesore të banorëve të saj. Terreni i veçantë dhe shumëfarësh i kësaj krahine, kullotat e panumërta të shumëllojshme, klima shumë e përshtatshme dhe mjeshtëria e blegtorit, e trashëguar nga brezi në brez në shekuj, janë tregues e, njëherazi, kushte të përshtatshme për mbarëshkrimin e bagëtive. Aty mbizotërojnë bagëtitë e imëta, numri i të cilave ka një peshë jo të vogël, kjo veti u ka çuar në krijimin e

një numri të madh emërtimeve për këto kafshë. Një pjesë e këtyre emërtimeve janë gjithëshqiptare, si nga koha e formimit ashtu edhe nga denduria e përdorimit, ndaj kanë zënë vend edhe në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Si të tilla ato janë pjesë e trashëgimisë së përbashkët kombëtare⁵.

Kafshë shtëpiake dhe shpendë

Nga kafshët shtëpiake më të **përmendura dalin**: *mushka, lopa, qeni, delja* ... etj.

Ka emërtime për kafshë të buta e të egra, emërtime për kafshë të imëta e për gjedhë, emërtime për qenë e për kafshë të mbartjes (të transportit), emërtime për shpend të butë e të egër⁶.

Emërtimet për kafshët e buta, që mbarështohen pranë shtëpisë në hapësirat e fshatit. Ngjyra është treguesi kryesor mbi të cilin ngrihen emërtimet, por motivim mund të bëhet edhe shenja në ballë a në trup të lopës a gjedhit, si: Si atë ditë kur polli *lopa*. *Bala* polli në mal e *çakejtë* i hëngrën *viçin*, kur po e nxirrte. **“Shokët”**, Si me hamendje çapiti te qoshku e shtriu dorën mbi vithen e tultë të *Larashit*. *Kau* përtypej më këmbë. **“Deti në mes”**.

Një tjetër kafshë që luan një rol të rëndësishëm në krahinën e Labërisë, për vlerat e saj në mish, qumësht e lesh është delja. Delja në Labëri mund të ketë edhe brirë. Prania e këtij tipari ka motivuar emërtime të tilla si: Leka i çonte atij që *ta mëndte* vetë, si ndonjë sheleg, *kërrutën e bardhë*. Dafina nuk e milte më atë *dele*. **“Deti në mes”**.

Qentë duke qenë kafshë të lëvizshme, janë përdorur emërtime të larmishme për t'i thirrur a për t'i ndjellë. Tregues motivues është zakonisht ngjyra e lëkurës: Drejt tyre u lëshua një qen, po fshatari iu gërmush:

- Hyyy, dreq! Mbylle gurmazin... Korbec! **“Deti në mes”**.

Kafshët që kanë shoqëruar më shumë stanin, kanë qenë mushkat, më pak për kuajt dhe gomarët⁷. Emërtimet e kafshëve të transportit janë bërë sipas ngjyrës, por edhe sipas një ndjesie të veçantë të pronarit rreth tyre si: *Mushka çile* me zilkë ishte e Dino Vllahut. **“Deti në mes”**, *Mushkën* e quanin Zogë..., **“Shokët”**.

Fshatari shkoj drejt e në ahur, i hodhi samarin *kërrit*, mori frerin nga trari dhe ia kaloi në gojë, Atëherë njerëzit panë Azem Bungën, që po vinte turfullim mbi kalin e vet, ... tërhiqte për freri *Këndrevicën*, siç i thërrisnin partizanët atij kali të lartë, qimekuq, që ia kishin marrë një oficeri madhor italian **“Shokët”**.

Për gomarët gati nuk ka shumë emërtime, nga që nuk dallohen për larmi ngjyrash: U duk një fshatar hipur mbi *gomar...*, **“Shokët”**. Tek-tuk ndeshim ndonjë si: Para mushkës së Dimo Vllahut shkonte *Ziushi*, gomari i kryeplakut. Ai ishte i vetmi gomar në Kodërdet, që kishte emër, që ushqej me tërshërë e mbahej në fre. Ishte i lartë si ndonjë at dhe samarin e kishte të mbuluar me qilim leshi të butë. **“Deti në mes”**.

⁵ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 47.

⁶ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 48.

⁷ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 53.

Emërtimi me emra të veçantë tregon për një lidhje të fortë shpirtërore që kjo krahinë lidh me kafshët shtëpiake, pasi me anë të tyre ka siguruar jetesën:

- Unë... grua... çupa... - thoshte ai tjetri. - Ti as që mund ta mendosh tani se ç'gëzim ka qenë për ty ajo *lopë e vetme*... Vërtet kemi qenë aq të lumtur? **“Deti në mes”**.

Duke jetuar shpesh me botën e gjësë së gjallë, banori i këtyre anëve ka krijuar dhe një pasuri gjuhësore të llojit tjetër, atë që përfshin njësitë frazeologjike⁸ të lidhura drejtpërdrejt a tërthorazi me këtë botë. Urtësia popullore, ndjenja e hollë e krijuesit të madh të mishëruara në këto shprehje të shkurtra, i japin ligjëritimit një gjallëri e larmi të këndshme. Ato shpesh sjellin në gjuhë vlera edhe më të mëdha se fjala, në përmbajtje dhe në ngjyrimin emocionale, sjellin nuanca të holla kuptimesh e përdorimesh, sjellin vështrim e vlerësim të botës ku gjallon labi apo më tej. Jo vetëm Labërishtja, por edhe vetë shqipja, është shumë e pasur në njësi frazeologjike që lidhen me këtë botë⁹:

Për ta ... *Ahuri i zbrazët është si shtëpia pa njerëz. Ke ftohtë të hysh në të.* **“Deti në mes”**; Është aq e fort kjo lidhje sa dhe marrëdhëniet midis tyre i krahasojnë me ato të kafshëve: *Po këtë ç'ma kishe lëshuar si viçin para lopës?* - i tha Mihalit. **“Deti në mes”**; Të gjithë do të jenë njëllor *si këmbët e dhisë?*, - pyeste Azem Bunga. **“Shokët”**.

Autori jep diçka më tepër rreth rritjes së këtyre kafshëve dhe plotësimit të nevojave me kafshë transporti më të mira me anë të kryqëzimit: Tani *kafshët, të ngjacuara*,¹⁰) i kullojnë fëmija arave, hendeqeve e gardhiqeve të fshatit. **“Deti në mes”**, Kur fshatarët donin që *gomaricat t'u pillnin pulishta race*, i hiqnin ato me gomarin e zotit Milo. Gomaricat pillnin *pulishta race, mushkës, lopën, qenve, e deleve*, **“Deti në mes”**.

Kafshë ujore: *qefulli, levreku, mushkonja, bretkosa, gaforre*, Me këmbët kredhur në baltë zunë të kapërdinin bretkosat. **“Deti në mes”**.

Nga shpendët kemi fjalët *pulë e zog*. E para lidhet me karakteristikën kryesore pranë detit dhe fjala zog na del me një semantikë më të gjerë: Ajo i kishte nxjerrë të kullotnin që në mëngjes herët *pulat e detit*. Ajo i druhej çdo fëshfërimë gjethe dhe ligjëritimit të *zogjve të natës*. Çuquriste *zogu i natës*. Ishte një zë i dhimbjes. O perëndi, që i mban të gjallë *zogjtë e qiellit*, pse e bëre kaq të rëndë jetën e njeriut mbi dhe! Shpirti i njeriut që fluturon si një *zog ere!* Flisnin një gjuhë të vet si ca *zogj shtegtarë* me zëra të ngjirur. Ndonjë supë e hollë me *mish zoge*, ndonjë vezë e freskët, që Leka ia jepte sapo e pillte pula në furrik etj.

Të bie në sy përmendja e të gjitha kafshëve shtëpiake apo e *gjënë e gjallë* si të **“Deti në mes”**, por interes paraqet sidomos leksiku që lidhet me emrat e veçantë që kjo zonë përdor për këto kafshë, si dhe emërtime sipas një veçorie, në përgjithësi të ngjyrës.

⁸ Njësitë frazeologjike që lidhen me botën e kafshëve janë trajtuar më gjerë në kapitullin e frazeologjisë.

⁹ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 48, f. 55.

¹⁰ Lidh me litar kalin, lopën etj., në një lëndinë a shesh, që të kullojë.

Fjalë që lidhen me bimësinë

Krahas blegtorisë një nga rrugët e rëndësishme të jetesës së kësaj krahine është bujqësia, e cila ka tradita shekullore në vendin tonë.

Shumica e këtij leksiku lidhen me emërtime objektesh konkrete, të cilat çdo gjuhë i ka të vetat. Autori na fut në një mjedis rural, jo se ai është autor i fshatit, por për të përjetuar estetikisht krijimin letrar dhe për të treguar se vendlindja zë një vend të rëndësishëm tek gjithsecili dhe Fatos Arapi është model i kësaj lidhje të fortë dashurie, të cilën duhet ta respektojmë me përvullje.

Ai e merr brumin gjuhësor të vendlindjes, e përdor mjeshtërisht, e pasuron me fjalë e shprehje, me lidhje të reja nga më mbresëlënëset, e pasuron me nuanca kuptimore dhe e risemantizon një pjesë të madhe të leksikut¹¹.

Leksiku që lidhet me botën bimërore është mjaft i larmishëm: Jani u ul poshtë barkut të Larashit dhe nisi të gërmonte me duar shtresën e *kashtës* e të plehut. Unë u çova t'i hidhja *lëpushka* kaut..., erë *ftonjsh* të pjekur. *Vreshtin, çeplaz*¹²), Ugoja qëndronte në vend, atje mes baltovinës përmes *kaçubave të zhukave* e të *marinave*¹³). *kallam të egër, gjembat e ferrave, bar e lëmyshk, çaj mali, rigon, ullinj të tërshërë, hardhi, fikut, rrush, stafidhe, grurë të zier, me arra, "Deti në mes"; borzilok e mëndrëz, në prushin e kuckave të thata të xinës, degët e mëlqinave, ngarkuar me duaj me misër. "Shokët"; kokrra gruri, plepi, bliri, shalqijë, pjepra, bifikë e gemb, portokallet. "Poezi".*

Në një klasifikim të mëtejshëm të këtyre bimëve (Tërësia e bimëve që rriten në një vend; bimët që rriten mbi tokë a në ujë, bota e bimëve.) do të kishim:

Bimë bujqësore: Jani u ul poshtë barkut të Larashit dhe nisi të gërmonte me duar shtresën e *kashtës* e të plehut. *tërshërë, "Deti në mes";* ngarkuar me duaj me *misër. "Shokët"; kokrra gruri, shalqijë, pjepra, "Poezi".*

Bimë të egra: gjembat e ferrave, bar e lëmyshk, bifikë e gemb, "Shokët".

Bimë të dobishme: hardhi, fikut, rrush, stafidhe, me arra, erë ftonjsh të pjekur. "Deti në mes"; limoni.

Bimë pyjore: plepi, në prushin e kuckave të thata të xinës, degët e mëlqinave, "Shokët".

Bimë zbukurimi: qipariza, dafina, "Deti në mes" bliri, "Poezi" bredhave, borzilok, "Shokët".

Bimë mjekësore: borzilok e mëndrëz, "Shokët"; dafina, "Deti në mes".

*Bimësi e kënetave: çeplaz*¹⁴), Ugoja qëndronte në vend, atje mes baltovinës përmes *kaçubave të zhukave* e të *marinave*) e *kallam të egër, "Deti në mes".*

Vlora, qytet bregdetar, me klimë të butë e të përshtatshme për *ullinj e portokalle*, siguron me anë të tyre një pjesë të mirë të ushqimit të përditshëm.

Poeti e vërtit rruzullin si një portokall në dorë siç bën ullinj të *flasin me zëra të gjelbër*. Më poshtë po sjellim lidhje interesante për ulli, ullishtë, vajulliri:

¹¹ Bar kënetash, me fletë të gjata, të ngushta dhe të mprehta si thikë.

¹² Bimë me fletë të holla që rritet nëpër ranishte ose anës lumenjve.

¹³ Bar kënetash, me fletë të gjata, të ngushta dhe të mprehta si thikë.

¹⁴ Bimë me fletë të holla që rritet nëpër ranishte ose anës lumenjve.

zgavër ulliri, hunj ulliri, rrënjë ulliri, një grusht ullinj të kripur, vaj ulliri, lulja e ullirit, siluetave të ullinjve, fletëzat e ullinjve, gjethëz ulliri, era e gjelbër e thellë e ullinjve, bojë ulliri, mbledhësit e ullinjve etj.

Ulli: Shohim një lidhje të fortë midis autorit dhe ullinjve: buzëve merr këtë gjethëz ulliri / Kur të të marrë malli. Ku është Orikumi e ku Aulona / Pa ullinjtë e gjelbër si mund të jesh **“Eklipsi i ëndrrës”**.

Ullinjtë janë identitetet tregues gjeo-fizik për fshatin. Rrënjët e ullinjve pleksen me rrënjët e tyre. Ata dhe ullinjtë janë bërë një. Aty nën ullinjtë shtrihej fshati. **“Deti në mes”**; Jam aromë prej ullinjsh, Në të hyrë të qytetit midis ullishtave pashë ushtarë italianë **“Eklipsi i ëndrrës”**; Nën ullinj gurë, kryqe varre, Përplasat vala nëpër rrënjë ulliri **“Poezi”**; Në të hyrë të qytetit midis ullishtave **“Shokët”**.

Ulliri shërben si vend ku mund të jesh i qetë, i patrazuar, ku mund të qeshësh apo edhe të qash. kokën e qethur në një zgavër ulliri dhe qante me ngashërim, **“Deti në mes”**; Kishin ngritur çadrat rrëzë ullinjve **Shokët**; Krishtin tim pashë në dy hunj ulliri **“In-tenebris”**.

Ulliri është ushqim i përditshëm i banorëve të kësaj zone. qefull të skuqur djathë e ullinj, bukës së misërt një grusht ullinj të kripur dhe një kokërr qepë, **“Deti në mes”**.

Ullinjtë janë pasuri e trashëgueshme, ata sigurojnë jetesën sot dhe nesër. Fundja ullishtën dhe tregtoreshin dhëndrit, ku të shiste verë, raki e vaj ulliri **“Deti në mes”**; Ullinjtë mitizohen, ata janë të pavdekshëm. Ullinjtë janë të pavdekshëm **“Eklipsi i ëndrrës”**; Ullinjtë janë pikë orientuese. Shtëpinë e vogël te kodra me ullinj në Vlorë.

Ullinjtë nuk janë thjesht bimë, ata janë më tepër se kaq, pasi janë pjesë e rëndësishme e botës së tyre shpirtërore. Si u dukën ullinjtë prej këndeje. Janë në vëzhgim të pandërprerë, perceptimi për ta është mjaft i ndier dhe delikat. Ka rënë drita e hënës mbi ullinj. Po zgjoheshin kodrat, ullinjtë, korija e dafinave. **“Deti në mes”**; Kishte çelur lulja e ullirit, Asgjë s’i trishton ullinjtë më shumë se udhët e luftës. Të gjakut mbijnë dhe ecin ullinjtë, siluetave të ullinjve, pa shpirtin tënd të ullirtë, **“Poezi”**; merr këtë gjethëz ulliri, si mbrëmjes Jonit fletëzat e ullinjve, Kishte çelur lulja e ullirit, Një veturë bojë ulliri e mbuluar me pluhur kaloi **“Eklipsi i ëndrrës”**; mbi një degëz ulliri, nëpër sponde të murmë ullinjsh, era e gjelbër e thellë e ullinjve, të dëgjoj zërat e gjelbër të ullirit, Thellë syve të saj ajo degë ulliri, **“Poezi”**; Një veturë bojë ulliri e mbuluar me pluhur kaloi **“Shokët”**.

Autori shpreh dashuri, admirim jo vetëm për ullinjtë por edhe për banorët, për jetën e vështirë dhe punën e rëndë në mbledhjen e ullinjve. A i ke parë ti mbledhësit e ullinjve. Duarbuhavitur qëmtojnë një kokërr këtu një kokërr atje, nëpër baltë e shi **“Poezi”**; në xhep e merr ca kokrra ullinj por mos i merr të gjitha **“Shokët”**; kemi vënë pak bukë ca kokrra ullinj e tre grushte grurë të zierë.

Lidhja me ullirin dhe portokallet është lidhje e fortë shpirtërore, dhe kjo është aq e vërtetë sa pothuaj në të gjitha lidhjet e këtyre fjalëve, kemi përdorime të figurshme të këto sintagma:

Po zgjoheshin kodrat, ullinjtë, korija e dafinave **“Deti në mes”**; pa shpirtin tënd të ullirtë, siluetave të ullinjve, breron mbi mua si mbi një ulli të gjelbër që

ecën dhe ndien, Asgjë *s'i trishton ullinjtë* më shumë se udhët e luftës, të gjakut mbijnë dhe *ecin ullinjtë*, **“Eklipsi i ëndrrës”**; drita e diellit *këtu i vranë ullinjtë* / Askush s'kujtohet për vdekjen **“In-tenebris”**; dëgjoj *zërat e gjelbër të ullirit* luhatjen **“Poezi”**.

Portokalle: varri i Batos ngrihej mbi tokë nën portokalle, punonte *bahçen e portokalles*, *Brymasi i ngrohtë i portokalleve* mbeti matanë, *Portokallet kishin zënë ca kokrra*, kishte soditur çdo rrënjë *portokalleje*, Ç'kërkonte ajo mbi *portokallen e gjelbër e të butë*, **“Shokët”**;

nga një pikë dielli *Çelën portokallet*, Vlorë maj **“Eklipsi i ëndrrës”**.

Si mund të kalohet Llogoraja pa ty?
Me një kokërr portokalle në dorë,
Llogoraja si mund të kalohet pa ty...

Një gardh qerpikësh prej *lulesh - limoni*.
Në buzë, të tjera prej portokalli.

Në gojë me lulet e bardha kisha kujtimin tënd,
ngjyer në erë portokallesh. **“Eklipsi i ëndrrës”**;

Krahasime: *Dhe vargjet erdhën me ritme të kaltra. Në degët e tyre figurat e gjelbra çelin, - si gjethet nëpër portokalla. Në degëza vargjesh fëshfërijnë figurat, si mbrëmjes Jonit fletëzat e ullinjve. Kur e di që unë po të mundnja, rreth vetvetes rruzullin do vërtitnja, si një portokall në dorën time “Eklipsi i ëndrrës”*.

Vendlindja e autorit mban aromë portokalle, aromën e ullinjve të pjekur, aromë pishe Llogoraje, aromë dafine, aromën e tokës së sapopunuar e erën e kripës së Jallisë ... etj., aroma që të lenë një shije të gjatë dhe të bëjnë të kthehesh përsëri në fletët e poezisë dhe të prozës së tij. Aty do të gjesh ngjyra pafund që nga e kaltra e Jonit, me gjelbërimin e përhershëm të ullinjve, *në lulet e bardha të portokalleve me diejt e verdhë në mes*. Me të kuqen e lulëkuqeve nëpër ara, por edhe me grinë e reve të Akrokerauntit.

Është më se e natyrshme, që poeti ynë fushën tematike e lidh me detin, me ullinjtë e portokallet, me botën bimore e shtazore, aq të larmishme të kësaj zone, duke i sjellë një pasuri leksikut të këtyre fushave.

Fatos Arapi së bashku me Ismail Kadare, Dritëro Agollin, Din Mehmetin, Ali Podrimen janë poetë elitarë, sepse vepra e tyre ka lexues të përhershëm në kohë dhe në hapësirë (pra në çdo periudhë të historisë dhe në mbarë trojet shqiptare dhe jashtë tyre, pasi çdo krijim i tyre leksikor apo semantik, çdo përdorim i figurshëm metaforik fiton një denduri të jashtëzakonshme përdorimi dhe bëhet pronë e shumë shqipfolësve dhe jo vetëm. Kjo nënkupton jo vetëm procesin kreativ krijues të gjuhës sonë, por dhe atë pasurues të gjuhës, sepse një njësi që i përket leksikut vetjak të një autori kur bëhet pronë e shumë përdoruesve kthehet në një pronë gjuhësore. Në këtë rast shfaqet edhe funksioni dhe roli i pazëvendësueshëm i

letërsisë për pasurimin, për latimin për zhërvjelltësinë dhe për rritjen e funksioneve shënjuese dhe shprehëse të fjalës shqip.

BIBLIOGRAFI

Vepra të shfrytëzuara

- F. Arapi, *Shokët*. Naim Frashëri, Tiranë, 1977.
F. Arapi, *Poezi*. Naim Frashëri, Tiranë, 1983.
F. Arapi, *Deti në mes*. Naim Frashëri, Tiranë, 1986.
F. Arapi, *In – tenebris*. Poezi. Marin Barleti, Tiranë, 1996.
F. Arapi, *Eklipsi i ëndrrës*. Poezi. Tiranë, 2002.
J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Dudaj, Tiranë, 2005.
Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2005.
V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.
Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës: Veçori leksiko-semantike dhe stilistike*, Tiranë, 2001.